



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:122347

Datë: 27.11.2023

Numri i dokumentit: 04976443

P.nr.1772/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit I. G. nga P., i akuzuar për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.3809/2020 të datës 29.09.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, i akuzuari I. G., me datë 21.11.2023 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 27.11.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari I. G., i biri i I. dhe nëna Sh., e gjinisë L., i lindur me ..., në P., me vendbanim në rruga "I. K." nr... P., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 04.09.2020, rreth orës 02:30, në magjistralen P.-P., në fshatin V. K. e F. K., i pandehuri derisa ishte duke e drejtuar automjetin A. A. me targa ..., në gjendje të dehur, në atë mënyrë që me të arritur në fshatin V., i njëjti ka humbur kontrollin mbi automjetin e tij dhe me atë rast ka dal nga rruga duke e goditur reklamën e firmës "T. G." si dhe autobusin i cili ishte jashtë shiritit qarkullues, ndërsa Policia i kanë bërë testin e alkoolit i cili ka rezultuar se i pandehuri ka 0,58 promila.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 23, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 371 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I. Për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së, të akuzuarit I. G., Gjykata i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 400.00 (katërqind) Euro, të cilën dënim, i akuzuari obligohet që të paguaj në afat prej, 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.3809/2020 të datës 29.09.2020, ndaj të akuzuarit I. G. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.11.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Besnik Jakupi, të akuzuarit I. G., ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë.

Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2020-TR-249, i datës 04.09.2020; Skica e aksidentit me numër 2020-TR-249 i datës 04.09.2020; Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin I. G., i datës 26.08.2020; Alkool testi për të pandehurin I. G., i datës 04.09.2020, si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me

pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit I. G. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me pakujdesi, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin. Gjithashtu i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer, po ashtu i njëjtë ka vepruar me pakujdesi. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata në kuptim të nenit 43 të KPRK-së të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjukata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Gjukata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest civil për realizimin e kërkesës së saj pasurore juridike.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjukata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1772/20 më datë 27.11.2023

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Albrim Kastrati

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë.